

V E N D I M
Nr.282 datë 14.6.1993

PËR LLOGARITË BANKARE TË INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE BUXHETORE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Çelja dhe mbyllja e llogarive bankare të institucioneve buxhetore dhe të njësive të tjera buxhetore bëhet vetëm me autorizim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.
2. Me përjashtim të rasteve të domosdoshme të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë nuk lejohet që institucionet buxhetore dhe njësitë e tjera buxhetore të kenë llogari depozitash në bankë.
3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë që në bazë të këtij vendimi të kryejë rregullimin e llogarive në bankë të institucioneve buxhetore dhe njësive të tjera buxhetore brenda datës 31 korrik 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi